

UNMIK/REG/2008/28
29 maj 2008

RREGULLORE NR. 2008/28

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 1999/13
MBI REGJISTRIMIN, LICENCIMIN, MBIKËQYRJEN DHE
RREGULLIMIN E INSTITUCIONEVE MIKROFINANCIARE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Në pajtim me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Pa konsultimit me Këshillim Ekonomik dhe Fiskal dhe me Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/13 të datës 16 tetor 1999 mbi licencimin e institucioneve jobankare mikrofinanciare në Kosovë,

Me qëllim të bërjes së ndryshimeve teknike të nevojshme për të reflektuar ndryshimet në praktikat e biznesit në institucionet mikrofinanciare që nga shpallja e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/13 të datës 16 tetor 1999 mbi licencimin e institucioneve jobankare mikrofinanciare në Kosovë,

Me anë të kësaj ndryshon nenet 1 deri në 39 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/13,

Si pasojë, Rregullorja do të ketë formulimin vijues nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje:

RREGULLORE NR. 1999/13

MBI REGJISTRIMIN, LICENCIMIN, MBIKËQYRJEN DHE RREGULLIMIN E INSTITUCIONEVE MIKROFINANCIARE

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Në pajtim me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Duke ditur se institucionet jobankare mikrofinanciare janë nën mbikëqyrjen e Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës ("AQBK") që është organ i pavarur sipas Kapitullit 11 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, me funksione dhe kompetenca të përkufizuara në Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2006/47 të datës 24 gusht 2006 mbi Autoritetin Qendror Bankar në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Fushëveprimi i Rregullores

Kjo Rregullore zbatohet për funksionimin e institucioneve mikrofinanciare në Kosovë, ashtu siç është përkufizuar me këtë Rregullore dhe me të sigurohet baza ligjore për regjistrimin dhe licencimin e tyre.

Neni 2

Përkufizimet

Në këtë Rregullore shprehjet vijuese kanë këto kuptime:

“Administrator” do të thotë çdo person duke përfshirë edhe personat juridikë, që është zyrtar i institucionit mikrofinanciar apo ndonjë person tjetër, duke përfshirë edhe ndonjë anëtar të Bordit drejtues apo Komisionit të auditimit, i cili vetëm apo bashkërisht me një apo me më shumë të tjerë ka autorizimin të bëjë zotime në llogari të institucionit të tillë mikrofinanciar apo personit juridik;

“Bankë” do të thotë person juridik me status të institucionit financiar por jo të institucionit mikrofinanciar, i angazhuar në pranimin e depozitave në Kosovë dhe shfrytëzimin e fondeve të tilla qoftë tërësisht apo pjesërisht për zgjerimin e kredive apo investimeve në llogari dhe me rrezik për personin që e drejton biznesin;

“Kapital” apo “Kapital aksionar” do të thotë vlera neto apo fondet e institucionit mikrofinanciar që paraqesin dallimin mes pasurisë dhe borxheve në përputhje me bilancin e gjendjes, i cili pasqyron standardet ndërkombëtare të kontabilitetit apo parimet e tjera të shëndosha të kontabilitetit, të pranueshme për AQBK-në, dhe përfshijnë, nëse institucioni mikrofinanciar është degë e institucionit mikrofinanciar të licencuar në ndonjë vend tjetër, edhe depozitin e tij që është i barabartë me kapitalin;

“Depoziti i barabartë me kapitalin” do të thotë shuma e parave që duhet të mbahet si depozit në Kosovë në vend të kapitalit, nga dega e institucionit mikrofinanciar që është e licencuar në vendin tjetër, në shumën e paraparë nga AQBK-ja;

“AQBK” do të thotë Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës;

“Kredit” do të thotë çfarëdo borxhi apo ndonjë obligim tjetër i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i pagesës së parave në këmbim të së drejtës për kthim të shumës së paguar dhe të asaj të mbetur, si dhe për pagesën e kamatës apo të ndonjë shpenzimi tjetër lidhur me atë shumë, çfarëdo vazhdimi i afatit për pagesën e borxhit, cilado garanci apo akreditiv, dhe çfarëdo angazhimi me qëllim të fitimit të së drejtës në pagesë të një shume parash.

“Depozit” do të thotë depozit në para që e ka pranuar institucioni mikrofinanciar, i cili duhet të paguhet në plotëni, me kamatë ose premi apo pa të, qoftë me kërkesë apo në kohën e pajtuar;

“Licencë” do të thotë autorizim i lëshuar nga AQBK-ja, përmes të cilit jepet e drejta për marrje me aktivitete financiare, të cekura në licencë;

“Hua” do të thotë çdo pagesë apo zotim për pagesë të një shume të hollash në këmbim të së drejtës për kthimin e shumës së paguar dhe të asaj të papaguar

dhe, me apo pa pagesë të kamatës apo të pagesave të tjera në atë shumë, duke përfshirë çdo zgjatje të afatit për pagesën e borxhit përkatës;

“Amvisëria me të hyra të ulëta” do të thotë amvisëria me të hyra bruto vjetore që janë të barabarta apo më të vogla se një e gjysma e shumës së të hyrës individuale bruto, e cila sipas Administratës Tatimore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave nuk tatimohet;

“Individi me të hyra të ulëta” do të thotë individi me të hyra vjetore bruto që janë të barabarta apo më të vogla se shuma e të hyrave individuale bruto, e cila sipas Administratës Tatimore të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, nuk tatimohet;

“Institucioni i licencuar mikrofinanciar” do të thotë institucioni mikrofinanciar që është i autorizuar të grumbullojë depozite të afatizuara dhe të kursimit që kalojnë shumën e gjithëmbarshme prej 125.000 euro apo kundërvlerën e kësaj shume në pajtim me licencën e lëshuar nga AQBK-ja;

“Institucioni mikrofinanciar” do të thotë personi juridik, veprimtaria kryesore e të cilit është ofrimi i mikrohuave, huave të vogla dhe të një numri të kufizuar të shërbimeve financiare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, për amvisëritë me të hyra të vogla dhe për individët;

“Urdhër” do të thotë direktivë obliguese e lëshuar nga AQBK-ja për bankën, institucionin financiar, institucionin mikrofinanciar, kompaninë e sigurimeve apo ndërmjetësuesin e sigurimeve ose për cilindo grup të tyre, përkitazi me zbatimin e rregulloreve dhe rregullave të tyre;

“Portofoli në rrezik” i referohet vlerës monetare të portofolit të huave të institucionit minus vlerat e pengut të përcaktuara në nenin 4 të Rregullës IX të AQBK-së;

“Portfoli në rrezik > 30 ditë” do të thotë pjesa e “portofolit në rrezik” të institucionit, për të cilin është tejkualuar më shumë se 30 ditë pagesa e kontraktuar e kryegjësë apo e kamatës;

“Veprimtaria kryesore” do të thotë jo më pak se 75% e mesatares e huave të gjithëmbarshme të papaguara të institucionit mikrofinanciar;

“Aksionari kryesor” do të thotë personi që është pronar i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i dhjetë apo më shumë për qind i çfarëdo klase aksionesh të bankës ose kompanisë me të drejtë vote;

“Likuidatori” do të thotë personi i emëruar nga AQBK-ja në pajtim me nenin 39 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/21 për licencimin e bankave, mbikëqyrjen dhe rregullimin përkitazi me qëllimet e përcaktuara;

“Institucioni i regjistruar mikrofinanciar” do të thotë institucioni mikrofinanciar që është i autorizuar të grumbullojë depozita të çfarëdo shume që nuk tejkalon 125.000 euro apo të kundërvlerës së saj, në pajtim me regjistrimin e tij në AQBK;

“Organizatrat e ndërlidhura afariste” do të thotë kompania holding, si dhe degët dhe (apo) filialat e saj; kompanitë simotra apo ndërmarrjet afariste me aksionarë të përbashkët, apo me partnerë të përbashkët ose nën kontroll të përbashkët, ku kontrolli nënkuptohet aftësinë për të ushtruar ndikim mbizotërues mbi menaxhimin dhe politikat e grupeve të tilla të personave juridikë në bazë të pronësisë, të shumicës së drejtorëve apo të cilëndo marrëveshjeje tjetër;

“Individët në lidhje farefisnore” do të thotë bashkëshorti apo bashkëshortja e individit, fëmijët e individit qofshin të rritur apo të mitur dhe pavarësisht nëse banojnë me individin, nënën, babanë, njerëzit, vëllezërit, vëllezërit nga njëri prind, motrat, motrat nga njëri prind, hallat, tezet, dajallarët, qofshin në vijë të gjakut apo nga martesë ose persona të tjerë, me të cilët individit ka marrëdhënie familjare;

“Personat e ndërlidhur” do të thotë, pa kufizim, çdo administrator i institucionit mikrofinanciar apo i institucionit financiar jobankar, çdo aksionar, çdo person që është i afërt me atë administrator, aksionar apo bartës të të drejtave të tjera që lidhen me martesë, afërsi të gjakut deri në shkallë të dytë apo interes afarist; ose cilido person që ka interes domethënës te personi juridik, ku institucioni mikrofinanciar ose institucioni jobankar financiar ka interes të rëndësishëm;

“Rregull” do të thotë direktivë obliguese që i drejtohet bankës, institucionit financiar, institucionit mikrofinanciar, kompanisë së sigurimeve apo ndërmjetësuesit të sigurimeve ose të cilido grupi të tyre, e cila lëshohet nga Bordi udhëheqës i AQBK-së me qëllim të zbatimit të dispozitave të rregullores (ve) që rregullojnë punën e tyre;

“Interes i rëndësishëm” do të thotë mbajtje e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e interesave në personin juridik apo në ndërmarrje që paraqet njëzet apo më shumë për qind të aksioneve të emetuara me të drejtë vote apo, i cili, sipas mendimit të AQBK-së, mundëson ushtrimin e ndikimit kontrollues në menaxhimin ose politikat e saj;

“Ndërmarrje e vogël” do të thotë ndërmarrje e cila ka deri më 9 punonjës dhe gjatë një periudhe prej 12-muajsh ka një shumë të përgjithshme të shitjeve prej 500,000 Euro ose më pak.

Neni 3

Ndalimet

3.1. Asnjë person nuk mund të angazhohet në biznesin e një institucioni mikrofinanciar pa u regjistruar së pari në AQBK.

3.2. Asnjë institucion mikrofinanciar i inkorporuar jashtë Kosovës nuk do të lejohet të angazhohet drejtpërdrejt në ndonjë aktivitet mikrofinanciar në Kosovë përveç nëse aktiviteti ndërmerret përmes një zyre të degës apo zyrës ndihmëse, të regjistruar sipas rregullit në AQBK.

3.3. Asnjë institucion i regjistruar mikrofinanciar nuk do të angazhohet në mbledhjen e depozitave që kalojnë shumë prej 125,000 Euro pa pasur licencë valide të lëshuar nga AQBK për këtë qëllim.

3.4. Asnjë institucion mikrofinanciar nuk do ta përdor fjalën “bankë”, apo ndonjë fjalë të prejardhur nga fjala “bankë” në titullin e tij, apo ndonjë fjalë tjetër që është çorientuese lidhur me aktivitetet e veta financiare, gjendjen e tij financiare, statusin ligjor apo lidhjen me qeverinë apo me institucionet ndërkombëtare.

3.5 Asnjë institucioni ekzistues mikrofinanciar nuk do t’i lejohet të vazhdojë veprimtarinë e tij pa aplikuar për regjistrim të ri sipas kësaj Rregulloreje brenda një periudhe gjashtë mujore nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje.

II. REGJISTRIMI DHE LICENCIMI I INSTITUCIONEVE MIKROFINANCIARE

Neni 4

Regjistrimi dhe licencimi i institucioneve mikrofinanciare

Vetëm AQBK-ja ka autorizimin për regjistrimin dhe licencimin e institucioneve mikrofinanciare që veprojnë në Kosovë.

Neni 5

Aplikimi për regjistrim të institucionit mikrofinanciar

5.1. Aplikacioni për regjistrim do të ketë formën e përshkruar nga AQBK-ja dhe do të përfshijë informacionet vijuese:

- i) Emrin, adresën dhe adresat ligjore të bizneseve në Kosovë;
- ii) Përfaqësuesin ligjor në Kosovë;
- iii) Adresën ligjore jashtë Kosovës, nëse është në përdorim;

- iv) Përfaqësuesin ligjor jashtë Kosovës, nëse është në përdorim;
- v) Emrin, adresën, shtetësinë dhe numrat e pasaportave të themeluesve të institucionit;
- vi) Në rastin e korporatës, emrin, adresën, shtetësinë dhe numrin e pasaportës së çdo aksionari, së bashku me shumën e aksioneve të tyre përkatëse dhe emrin, adresën, shtetësinë dhe numrin e pasaportës së çdo drejtori të korporatës;
- vii) Në rastin e një institucioni ose të një organizate joqeveritare (“OJQ”), emrin, adresën, shtetësinë dhe numrin e pasaportës të çdo drejtori, menaxheri ose personit ekzekutues të institucionit ose OJQ-së;
- viii) Në rastin e ortakërisë, marrëveshjen mbi themelimin e ortakërisë dhe emrin, adresën, shtetësinë dhe numrin e pasaportës të çdo pjesëtar;
- ix) Emrin, adresën dhe informacione të tjera kontaktuese të çdo individit të autorizuar që të bashkëpunojë me AQBK në procesin e shqyrtimit të aplikacionit për regjistrim;
- x) Kopje të instrumentit apo marrëveshjes mbi themelim, dispozitat e marrëveshjes mbi ortakërinë, statutin, aktet nënligjore ose marrëveshjet e zbatueshme të asociacionit;
- xi) Raporte të kontrolluara financiare të aplikantit për dy vitet e kaluara;
- xii) Një plan biznesi ku përshkruhet tregu dhe aktivitetet e planifikuara në Kosovë për së paku tri vite, duke dhënë detaje për prodhimet e propozuara dhe të portofolit të planifikuar të huave, si dhe të burimeve të financimit të aktiviteteve, duke përfshirë financimin e bërë nga themeluesit dhe nga burimet e tjera; bilancin fillestar të planifikuar të gjendjes, dhe pasqyrat e planifikuara financiare (bilanci i gjendjes dhe pasqyra e të hyrave) për së paku tri vite dhe
- xiii) Informacione shtesë të cilat AQBK-ja i konsideron të duhura.

5.2. Në aplikacion mund të sigurohen edhe informacione shtesë që aplikanti i konsideron të duhura dhe kjo shoqërohet me pagesën e një tarife të caktuar, e cila pagesë nuk kthehet.

Neni 6

Regjistrimi i institucioneve mikrofinanciare

6.1 Pas pranimit të aplikacionit sipas nenit 5 lart, AQBK-ja shqyrton të dhënat e dorëzuara, dhe pasi që të konstatojë se të dhënat janë të kompletuara e njofton aplikantin me shkrim në përputhje me rrethanat.

6.2 Jo më vonë se 90 ditë pasi që AQBK-ja të ketë njoftuar aplikantin se aplikacioni për regjistrim është i kompletuar, AQBK-ja nxjerr vendim me të cilin e miraton apo e refuzon regjistrimin. Me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet AQBK-së dhe aplikantit, periudha për marrjen e vendimit mund të

zgjatet deri në 90 ditë. Në njoftimin mbi refuzimin e regjistrimit shënohen arsyet pse është refuzuar regjistrimi.

6.3. Regjistrimi i institucionit mikrofinanciar miratohet për një periudhë të pacaktuar kohore dhe nuk mund të transferohet. Pas regjistrimit, institucioni mikrofinanciar fillon veprimtarinë brenda gjashtë muajsh nga dita e njoftimit mbi regjistrimin. Nëse brenda kësaj kohe nuk e fillon veprimtarinë, regjistrimi bëhet i pavlefshëm. Institucioni mikrofinanciar mund të riaplikojë për regjistrim.

6.4. Institucionet e regjistruara mikrofinanciare do të shënohen në listën e institucioneve financiare të mbajtura nga AQBK-ja.

Neni 7

Kushtet paraprake për licencimin e institucioneve mikrofinanciare

7.1. Për të qenë të autorizuar për mbledhjen e depozitave nga anëtarët e tyre apo nga populli për një shumë të përgjithshme që kalon 125,000 Euro, institucionet mikrofinanciare duhet të aplikojnë dhe të marrin licencë nga AQBK.

7.2. Çdo aplikant për licencë nga AQBK së pari duhet të plotësojë kushtet vijuese në kohën e aplikimit për licencë:

- i) Regjistrimi si institucion mikrofinanciar në AQBK;
- ii) Regjistrimi si biznes në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë;
- iii) Të ketë vepruar si institucion mikrofinanciar në Kosovë për tri vite;
- iv) Të ketë regjistruar çdo vit gjatë tri viteve të fundit tepricën apo fitimin në punë pas heqjes së humbjeve nga huat dhe shlyerjet;
- v) Të ketë regjistruar çdo vit gjatë tri viteve të fundit koeficientin e portofolit në rrezik > 30 ditë dhe të koeficienteve të tjerë të cilësisë së portofolit të huave, siç parashihet sipas rregullave në fuqi të AQBK-së;
- vi) Të ketë regjistruar gjatë tri viteve të fundit shpenzimin maksimal vjetor të humbjeve në dhënien e huave si përqindje të portofolit mesatar bruto, siç është paraparë sipas rregullave në fuqi të AQBK-së dhe
- vii) Të ketë kapitalin minimal dhe rezervat e paguara apo minimumin e kapitalit aksionar, siç parashihet sipas rregullave në fuqi të AQBK-së.

Neni 8

Aplikimi i institucioneve mikrofinanciare për licencë

8.1. Aplikacioni për licencë i institucionit mikrofinanciar do të jetë në formën e përshkruar nga AQBK-ja dhe do të përfshijë informacionet vijuese:

i) Emrin, adresën, shtetësinë dhe numrin e pasaportës së aksionarëve të institucionit mikrofinanciar, me shumën e aksioneve të tyre (numrin e aksioneve, shumën e paguar dhe atë që mbetet për t'u paguar, përqindja e kapitalit);

ii) Emrin, adresën, shtetësinë, numrin e pasaportës, të dhënat biografike (duke përfshirë edhe kualifikimet profesionale dhe përvojën e punës për dhjetë vitet e kaluara) dhe raportet financiare për tri vitet e kaluara të çdo personi i cili është apo propozon që të jetë aksionar kryesor ose që ka apo propozon që të ketë interes të rëndësishëm në institucionin mikrofinanciar dhe shumë të përqindjes në të; interesat e propozuara të pronësisë të personave të bashkëngjitur ose të afërt do të përlllogariten për të përcaktuar shumën e interesit të tillë; dhe drejtorëve e anëtarëve të menaxhmentit të përgjithshëm të institucionit mikrofinanciar;

iii) Emrin, adresën dhe informacione të tjera kontaktuese të individit të autorizuar që të bashkëpunojë me AQBK-në në procesin e shqyrtimit të aplikacioneve për licencim;

iv) Kopje e përditësuar e statutit, aktit themeltar, akteve nënligjore ose marrëveshjeve për asociim të institucionit mikrofinanciar;

v) Raporte të kontrolluara financiare për tri vitet e kaluara (nëse institucioni mikrofinanciar është degë e një institucioni të huaj, raporte të kontrolluara financiare të punës në Kosovë, dhe të institucionit të huaj që e posedon degën në Kosovë);

vi) Një plan biznesi ku përshkruhet, mes tjerash, tregu dhe aktivitetet e pritura në Kosovë për tri vitet e ardhshme, duke dhënë detaje për prodhimet e propozuara dhe për portofolin e parashikuar të huave, burimet për financimin e aktiviteteve duke përfshirë edhe financimin e siguruar nga themeluesit dhe nga burimet tjera, bilancin e parashikuar fillestar të gjendjes dhe pasqyrat financiare të parashikuara (bilancet e gjendjes dhe pasqyrat e të hyrave);

vii) Diagramin organizativ të institucionit mikrofinanciar, përshkrimin e shkurtër të sistemeve të menaxhimit të informatave të tij dhe të sistemeve të TI-së, politikat e tij të kreditimit e të financimit dhe të doracakëve të tij të menaxhmentit e të punës;

viii) Informacione të tjera të kërkuara nga AQBK-ja për të siguruar AQBK-në se institucioni mikrofinanciar është dhe do të vazhdojë të jetë në pozitë që të përmbushë përgjegjësitë dhe detyrimet e veta ashtu siç do të paraqiten, dhe se punët e institucionit mikrofinanciar nuk ka mundësi që të kryhen ashtu që të jenë të dëmshme për interesat e klientëve të tij dhe

ix) Informacione të tjera shtesë që AQBK-ja i konsideron të duhura.

8.2. Në aplikacion shënohen informacione shtesë që aplikanti i konsideron të duhura dhe aplikacioni shoqërohet me pagesën e tarifës së paraparë, e cila tarifë nuk kthehet.

Neni 9

Licencimi i institucioneve mikrofinanciare

9.1. Pas marrjes së aplikacionit sipas nenit 8 lart, AQBK-ja shqyrton informacionin e dorëzuar dhe pasi që të dhënat t'i konsideron të kompletuara e njofton aplikantin për këtë me shkrim.

9.2. Jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të aplikantit nga AQBK-ja se aplikacioni i institucionit mikrofinanciar për licencim është i kompletuar, AQBK-ja nxjerr vendim preliminar me të cilin e miraton apo e refuzon licencën. Me marrëveshje të ndërsjellë në mes të AQBK-së dhe aplikantit, periudha për marrjen e vendimit mund të vazhdohet deri më 90 ditë. Në njoftimin mbi refuzimin e licencës shënohen arsyet e refuzimit të licencës.

9.3. Në rastin e miratimit preliminar të një aplikacioni për licencim të institucionit mikrofinanciar, AQBK-ja do të rendit kushtet sipas të cilave institucioni mikrofinanciar mund të merr licencën. Kushtet e tilla, mes tjerash, përfshijnë:

- i) Pagesën e kapitalit minimal që kërkohet nga institucionet mikrofinanciare në pajtim me nenin 19 të kësaj Rregulloreje;
- ii) Sipas nevojës, punësimin dhe trajnimin e stafit shtesë, dhe marrjen me qira apo blerjen e pajisjeve dhe sistemeve për punë shtesë për të kryer aktivitetet e lejuara të shënuara në nenin 12 dhe
- iii) Angazhimin e auditorëve të jashtëm dhe të brendshëm në pajtim me nenin 26 të kësaj Rregulloreje.

9.4. Pas miratimit, licenca lëshohet për periudhë të pacaktuar kohore dhe ajo nuk mund të transferohet. Pas marrjes së licencës, institucioni mikrofinanciar fillon korrespondimin e aktiviteteve të lejuara brenda gjashtë muajsh nga dita e njoftimit mbi licencën. Nëse veprimet nuk i fillon brenda kësaj kohe, licenca bëhet e pavlefshme. Institucioni mikrofinanciar mund të riaplikojë për licencë.

9.5. Institucionet e licencuara mikrofinanciare do të shënohen në regjistrin e institucioneve financiare të mbajtura nga AQBK-ja.

Neni 10

Anulimi i licencës dhe tërheqja e regjistrimit të institucioneve mikrofinanciare

10.1. AQBK-ja mund të anulohet licencën e institucionit mikrofinanciar apo të tërheqë regjistrimin e tij në bazë të njëjës apo më shumë arsyeve vijuese:

i) Nëse vërtetohet se regjistrimi apo licencimi i institucionit mikrofinanciar është bërë në bazë të informacioneve të rreme apo çorientuese;

ii) Nëse institucioni mikrofinanciar pushon të kryej aktivitetet e veta primare;

iii) Me kërkesë të institucionit mikrofinanciar pas marrjes së vendimit për mbyllje të institucionit mikrofinanciar dhe duke iu nënshtruar kushteve të shqiptuara nga AQBK-ja;

iv) Nëse pranimi i depozitave kalon 125,000 Euro ose kundërvlerën e kësaj pa pasur licencë institucioni mikrofinanciar që të mbledhë depozita;

v) Nëse institucioni mikrofinanciar nuk respekton rregulloret, rregullat dhe kërkesat e arsyeshme të cilat zbatohen për institucionet e tilla, apo urdhrat e lëshuar nga AQBK-ja, dhe brenda periudhës për të cilën janë pajtuar nuk i ka korrigjuar të metat dhe parregullsitë e vërejtura nga AQBK-ja;

vi) Nëse institucioni mikrofinanciar qëllimisht paraqet raporte mashtruese apo vazhdimisht i paraqet AQBK-së raporte me informacione të rrejshme, apo nuk i paraqet me kohë AQBK-së informacionet dhe dokumentacionin e kërkuar nga kontrolluesit e autorizuar të AQBK-së;

vii) Nëse sipas mendimit të AQBK-së institucioni mikrofinanciar është angazhuar në biznes ilegal apo punë që shkaktojnë shtrembërime të mëdha në tregjet relevante dhe si pasojë i shkaktojnë dëme të rënda financiare institucionit financiar që vepron në Kosovë;

viii) Nëse institucioni amë i institucionit mikrofinanciar pushon aktivitetet e veta primare në shtetin amë dhe

ix) Nëse sipas mendimit të AQBK-së, institucioni mikrofinanciar bankroton apo së shpejti mund të bankrotojë. Në këtë rast, AQBK-ja mund të ushtrojë disa apo të gjitha veprimet e parapara në kapitullin IX të kësaj Rregulloreje.

10.2. Vendimi për anulimin e licencës së një institucioni mikrofinanciar apo për tërheqjen e regjistrimit të tij do të botohet në një apo në më shumë gazeta me tirazh të gjerë kudo që të jetë e vendosur zyra kryesore e institucionit mikrofinanciar.

10.3. Institucioni mikrofinanciar licenca e të cilit është anuluar apo regjistrimi i të cilit është tërhequr do të pushojë së kryeri shërbime mikrofinanciare në Kosovë, përveç rasteve të lejuara nga AQBK-ja me qëllim të mbylljes apo likuidimit të biznesit të tij.

III. AKTIVITETET E LEJUARA

Neni 11

Aktivitetet e lejuara të institucioneve të regjistruara mikrofinanciare

11.1. Qëllimi kryesor i institucioneve të regjistruara mikrofinanciare është që të sigurojë hua kryesisht për familjet dhe individët me të ardhura të ulëta dhe për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

11.2. Shuma e përgjithshme maksimale e huave të pakthyera ndaj ndonjë individi apo ndaj grupit të personave të afërt nuk mund t'i tejkalojë shumat e parapara nga AQBK-ja. Shuma e përgjithshme maksimale e huave të pakthyera ndaj ndonjë ndërmarrjeje apo ndaj një grupi të interesave të ndërlidhura të bizneseve dhe të interesave të rëndësishme nuk tejkalon shumën e paraparë nga AQBK-ja.

11.3. Institucionet e regjistruara mikrofinanciare mund të angazhohen edhe në aktivitetet vijuese:

- i) Duke ofruar shërbime të kufizuara të pagesave lidhur me huat e dhëna klientëve;
- ii) Përfitim të fondeve me anë të granteve apo me huazime me qëllim të huadhënies apo për përdorimin e tyre;
- iii) Huazimi nga dhe vendosja e fondeve në tregje dhe institucione të miratuara nga AQBK-ja me qëllim të menaxhimit të likuiditetit të tyre;
- iv) Sigurimi i huave për të financuar blerjen e pajisjeve;
- v) Përfitimi, posedimi, dhënia me qira, marrja me qira mirëmbajtja, transferimi, shitja ose largimi i çdo pasurie të paluajtshme apo të luajtshme që është shfrytëzuar për realizimin e biznesit të tyre dhe
- vi) Sigurimi i ndihmës financiare, teknike dhe profesionale dhe trajnimi i klientëve të tyre apo ofrimi i ndihmës që atyre tu ofrohen shërbime në fushat e tilla.

Neni 12

Aktivitetet e lejuara të institucioneve të licencuara mikrofinanciare

Përveç aktiviteteve të cilat mund të kryhen nga institucionet e regjistruara mikrofinanciare, institucionet e licencuara mikrofinanciare janë të autorizuar që të angazhohen në aktivitetet vijuese:

- i) Pranimin e depozitave të kursimit dhe depozitave me afat në monedhat zyrtarisht të përdorura në Kosovë;
- ii) Blerjen dhe shitjen e këmbimeve të jashtme në një vend bazë për anëtarët e tyre dhe klientët me kusht që ata të mos kenë llogari të hapura në monedha të huaja;
- iii) Ofrimi i instrumenteve jofinanciare kreditore (siç janë akreditivët, fletobligacionet dhe garancionet) për klientët e tyre me kusht që këto instrumente të jenë plotësisht të siguruara përmes depozitave në para të gatshme në valutë të njëjtë me atë të instrumentit dhe
- iv) Shërbime të tjera të tilla të autorizuara veçanërisht nga AQBK-ja.

Neni 13

Aktivite të tjera të institucioneve mikrofinanciare

13.1. Institucionet e regjistruara apo të licencuara mikrofinanciare mund të angazhohen në aktivite të tilla të tjera financiare që AQBK-ja mund t'i caktojë sipas rregullit.

13.2. AQBK-ja me rregull mund të caktojë kushte të caktuara të punës që vlejné për kryerjen e aktiviteteve të autorizuara nga institucioni mikrofinanciar, dhe institucioni mikrofinanciar i regjistruar apo i licencuar sipas kësaj Rregulloreje duhet t'iu përmbahet këtyre rregullave.

13.3. AQBK-ja gjithashtu mund të ndalojë apo kufizojë çdo institucion mikrofinanciar të regjistruar apo të licencuar që të angazhohet në cilindo nga aktivitetet e lejuara. Në rastet e tilla, AQBK-ja ofron arsyen(et) me shkrim për vendimin e tij.

IV. ORGANIZIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONEVE MIKRO FINANCIARE

Neni 14

Transaksionet për të cilat kërkohet autorizim paraprak nga AQBK-ja

Miratimi paraprak me shkrim nga AQBK-ja kërkohet për:

- i) Ndryshimin e emrit të institucionit mikrofinanciar;

- ii) Ndryshimin e lokacionit të një institucioni mikrofinanciar;
- iii) Shitjen apo transferimin e biznesit të tij një subjekti tjetër;
- iv) Bashkimin apo shkrirjen e institucionit mikrofinanciar dhe
- v) Nëse institucioni mikrofinanciar është kompani, të gjitha transaksionet dhe veprimet lidhur me kapitalin e saj aksionar që sjellin te ndryshimi i listës së aksionarëve, të cilët posedojnë 10% apo më shumë të kapitalit aksionar dhe (apo) të të drejtave të votës në kompani.

Neni 15

Qeverisja e institucioneve mikrofinanciare

Punët e një institucioni mikrofinanciar qeverisen dhe menaxhohen nga dhe nën drejtimin e organeve të veta ekzekutive, në pajtim me ligjin në fuqi dhe me statusin ligjor të institucionit për aq sa të mos jenë jokonsistente me këtë Rregullore. Ata kryhen në pajtim me parimet e pranuar të qeverisjes së mirë për të siguruar që biznesi i institucionit të kryhet në mënyrë të sigurt dhe të bazuar. Institucioni mikrofinanciar duhet t'iu përmbahet të gjitha rregulloreve dhe rregullave të zbatueshme të nxjerra nga AQBK-ja.

Neni 16

Bordi drejtues

16.1 Institucioni i licencuar mikrofinanciar administrohet nga Bordi drejtues i cili përbëhet nga një numër tek prej jo më pak se tre anëtarë, nga të cilët dy duhet të jenë pa funksione ekzekutive apo menaxhuese në institucion. Të gjithë anëtarët e Bordit drejtues do të jenë “të përshtatshëm dhe të duhur” dhe me reputacion të mirë, duke i plotësuar kriteret e caktuara nga AQBK-ja lidhur me kualifikimet, përvojën dhe integritetin e anëtarëve të Bordit drejtues të një banke. Para se ta marrin detyrën, anëtarët e Bordit drejtues të institucionit të licencuar mikrofinanciar duhet të kenë miratim me shkrim nga AQBK-ja.

16.2 Bordi drejtues dhe anëtarët e tij nuk mund t'i delegojnë përgjegjësitë e veta tek të tjerët.

Neni 17

Komitetet

Bordi drejtues i institucionit të licencuar mikrofinanciar ndihmohet nga së paku tri komitete për menaxhimin, organizimin, administrimin dhe funksionet kontrolluese:

- i) Komiteti i auditimit i cili përfshin - dhe kryesohet nga – një anëtar joekzekutiv i Bordit drejtues;

- ii) Komiteti për menaxhimin e rrezikut të kredisë dhe
- iii) Komiteti për menaxhimin e aseteve dhe detyrimeve.

Detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre komiteteve janë të përshkruara në nenin 20 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/21. Mbledhjet e rregullta të komiteteve konvokohen sipas një kalendari të caktuar nga Bordi drejtues. Mbledhjet e jashtëzakonshme të komiteteve mund të konvokohen nga dy anëtarë të Bordit drejtues apo nga dy anëtarë të komitetit.

Neni 18

Drejtori ekzekutiv – Kryeshefi ekzekutiv

Aktivitetet e përditshme të institucionit të licencuar mikrofinanciar janë përgjegjësi e drejtorit ekzekutiv apo e kryeshefit ekzekutiv apo menaxherit të përgjithshëm të caktuar nga Bordi drejtues i cili i raporton atij. Ky person nuk mund të shërbejë njëkohësisht si kryesues i Bordit drejtues.

Neni 19

Fshehtësia

Anëtarët aktual dhe ata të kaluar të Bordit drejtues, punonjësit dhe agjentët e institucionit mikrofinanciar mbajnë në fshehtësi dhe nuk e shfrytëzojnë për përfitim personal apo përfitim të tjetrit përveç institucionit mikrofinanciar se ata shërbejnë apo kanë shërbyer ose që lejojnë të kontrollohen nga të tjerët, çfarëdo informacioni jopublik që ata e kanë marrë gjatë shërbimeve të tyre në institucionin mikrofinanciar. Informacionet e tilla mund t'i shpalosen vetëm AQBK-së, duke përfshirë edhe inspektorët e tij dhe auditorët e caktuar nga ky autoritet, auditorët e jashtëm të institucionit mikrofinanciar, autoritetet gjyqësore të paraparë me ligjin në fuqi, autoritetet mbikëqyrëse të bankave të huaja nëse institucioni mikrofinanciar i nënshtrohet një mbikëqyrje të tillë, dhe në procedura gjyqësore ku përfshihet institucioni mikrofinanciar ku një shpalosje e tillë kërkohet nga gjykata.

V. KËRKESAT E ARSYESHME PËR INSTITUCIONET E LICENCUARA MIKROFINANCIARE

Neni 20

Kapitali minimal

20.1 Vetëm AQBK-ja ka përgjegjësinë për caktimin e shumës minimale të kapitalit të paguar ose të kapitalit aksionar që duhet të ruhet nga institucionet e

licencuara mikrofinanciare, e cila shumë e kërkuar asnjëherë nuk mund të jetë më e vogël se 2,500,000 Euro. AQBK-ja mund të rrisë shumën e tillë minimale të kërkuar herë pas herë me anë të një rregulle ose urdhri.

20.2 Të gjitha kreditë e dhëna nga institucioni i licencuar mikrofinanciar anëtarëve të Bordit drejtues; drejtorit të tij ekzekutiv apo kryeshefit ekzekutiv a menaxherit të përgjithshëm; atyre që kanë interes të rëndësishëm dhe atyre që janë individë të afërt apo organizata afariste përkitazi me të lartpërmendurit do të zbriten nga kapitali aksionar i paguar me qëllim të krijimit të përputhshmërisë me rregullat dhe urdhrat e AQBK-së.

Neni 21

Kapitali aksionar dhe detyrimet

21.1. Detyrimet e përgjithshme të institucionit të licencuar mikrofinanciar nuk mund të kalojnë pesë herë shumën e kapitalit aksionar të tij të përkufizuar për atë qëllim nga AQBK-ja.

21.2. Shuma e përgjithshme e depozitave të mbledhura nga individë apo personi apo nga një grup i individëve apo personave të lidhur nuk do të kalojë shumën apo përqindjet e kapitalit apo depozitave të përgjithshme të përshkruara nga AQBK-ja.

Neni 22

Likuiditeti dhe përputhja e pasurive dhe detyrimeve

22.1. Institucionet e licencuara mikrofinanciare kërkohet që në çdo kohë të kenë rezerva minimale të likuiditetit, të përlllogaritura si përqindje e depozitave të tyre, ashtu siç parashihet nga AQBK-ja.

22.2. Institucionet e licencuara mikrofinanciare sigurohen që në mënyrë adekuate t'i përputhin burimet financuese me afate të maturuara.

Neni 23

Portofoli i huave

AQBK-ja mund të parasheh përmes rregullës kufizimet individuale dhe të përgjithshme ndaj ekspozimit në rreziqe përkitazi me kreditë e dhëna nga institucioni mikrofinanciar.

Neni 24

Klasifikimet e kredive dhe rezervat minimale

Jo më shpesh se një herë në tre muaj, institucionet e licencuara mikrofinanciare do të bëjnë vetëklasifikimin e rreziqeve të tyre të kredisë në përputhje me rregullën e AQBK-së IX dhe i përcaktojnë rezervat kreditore për huat me vlerë të zvogëluar.

Neni 24

Mbrojtja e konsumatorit

Institucionet e licencuara mikrofinanciare do t'iu sigurojnë depozituesve të tyre, huamarrësve dhe të tjerëve me të cilët ata angazhohen në biznes financiar informacione adekuate mbi kushtet dhe detyrat e cilitdo obligimi kontraktues, në pajtim me rregullat dhe dekretet relevante të AQBK-së.

VI. KONTABILITETI, AUDITIMI DHE RAPORTIMI FINANCIAR

Neni 25

Llogaritë dhe pasqyrat financiare

25.1. Të gjitha institucionet mikrofinanciare mbajnë llogaritë dhe regjistrat, si dhe përgatisin pasqyra vjetore financiare, që janë adekuate në pasqyrimin e punëve të tyre dhe kushtet financiare në përputhje me standardet ndërkombëtarisht të pranueshme të kontabilitetit. Llogaritë dhe regjistrat gjithashtu pasqyrojnë punën dhe kushtet financiare të degëve të tyre dhe filijalave si në mënyrë individuale, ashtu edhe në atë të konsoliduar. Raportet rregullative për AQBK-në përgatiten si të konsoliduara, duke konsoliduar të gjitha veprimtaritë financiare të të gjitha zyrave të Kosovës.

25.2. Llogaritë dhe pasqyrat financiare përgatiten në atë formë dhe në ato hollësi, si dhe në përputhje me standardet ndërkombëtarisht të pranuar të kontabilitetit, ashtu siç e parasheh AQBK-ja.

Neni 26

Auditimi

Të gjitha institucionet do të caktojnë auditor të jashtëm. Përveç kësaj, të gjitha institucionet e licencuara mikrofinanciare do të kenë një auditor të brendshëm të miratuar nga AQBK-ja në pajtim me kushtet e paraqitura në nenin 33 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/21. Detyrat e këtyre auditorëve do të jenë të njëjta sikurse ato të shënuara në nenin 33 të asaj Rregulloreje, dhe ashtu siç do të specifikohet me rregullat e AQBK-së.

VII. MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI I TË GJITHA INSTITUCIONEVE MIKROFINANCIARE

Neni 27 Raportimi në AQBK

Të gjitha institucionet mikrofinanciare ia raportojnë aktivitetet e tyre AQBK-së në pajtim me përshkrimin në regjistrimin apo licencën e tyre, dhe në mënyrën e përshkruar herë pas herë nga AQBK-ja.

Neni 28 Kontrollimi

Të gjitha institucionet mikrofinanciare i nënshtrohen kontrollit nga kontrolluesit e AQBK-së apo nga agjentët e caktuar nga AQBK-ja. Kontrolluesit e tillë mund të jenë zyrtar të autoriteteve të një shteti tjetër që janë ngarkuar me mbikëqyrjen e detajuar të aktiviteteve financiare në atë shtet kur institucioni është degë ose organ ndihmës i institucionit mikrofinanciar që mbikëqyret nga rregullatori i shtetit tjetër.

VIII. SHKELJET, SANKSIONET DHE MASAT PËRMIRËSUESE

Neni 29 Shkeljet, sanksionet dhe masat përmirësuese

29.1. AQBK-ja mund të ndërmarrë një apo më shumë nga veprimet vijuese apo të shqiptojë sanksionet vijuese lidhur me institucionin mikrofinanciar, nëse AQBK-ja, në konstatimet e veta, konstaton se institucioni mikrofinanciar apo ndonjëri nga administratorët e tij ose mbajtësit e interesit të rëndësishëm e kanë shkelur një dispozitë të kësaj Rregulloreje apo ndonjë rregull a urdhër të

AQBK-së, kanë shkelur ndonjë kusht apo kufizim lidhur me autorizimin e lëshuar nga AQBK-ja, ose janë angazhuar në punë të pasigurta dhe të pabazuara:

- i) Jep vërejtje me shkrim;
- ii) Kërkon nga institucioni mikrofinanciar që të paraqesë plan përmirësues;
- iii) Bën marrëveshje me shkrim me Bordin drejtues për sigurimin e një programi për veprime përmirësuese;
- iv) Cakton afate dhe/ose vendos kufizime të aktiviteteve dhe veprimeve të institucionit mikrofinanciar;
- v) Nxjerr urdhra me shkrim për ndaljen dhe shmangien nga shkeljet e tilla, si dhe ndërmerr veprime korigjuese;
- vi) Shqipton gjoba për institucionin mikrofinanciar apo administratorët e tij, për aksionarët kryesor ose për mbajtësit e interesit të rëndësishëm, në shuma prej 100 deri në 1,000 Euro për çdo ditë sa vazhdon shkelja, me kusht që gjobat të jenë shuma të ngjashme për subjekte me asete të përgjithshme të krahasueshme për llojin e njëjtë të shkeljes;
- vii) Cakton këshilltar për institucionin mikrofinanciar;
- viii) Suspendon përkohësisht apo shkarkon menaxhmentin apo anëtarin ose anëtarët e tij, Bordin e guvernatorëve apo ndonjë anëtar ose anëtarë të tij;
- ix) Cakton një administrator të përkohshëm në vend të menaxhmentit aktual dhe
- x) Anulon licencën dhe regjistrimin e institucionit mikrofinanciar dhe cakton një likuidator në pajtim me nenin 32 të kësaj Rregulloreje.

29.2. Masat dhe sanksionet e parapara në këtë nen nuk përjashtojnë zbatimin e dënimeve të tjera civile apo dënimeve penale ashtu siç parashihet me ligjin në fuqi.

29.3. Çdo gjobë apo shumë e shqiptuar në pajtim me këtë nen do të paguhet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

29.4. Sanksionet e përshkruara në këtë nen mund të zbatohen për cilindo person i cili shkel cilëndo nga dispozitat e nenit 3, dhe AQBK-ja gjithashtu do të ketë kompetenca që të kërkojë likuidimin e biznesit të personit të tillë sipas dispozitave të ligjit në fuqi, pavarësisht dispozitave të tjera të ligjit.

Neni 30

Suspendimi dhe largimi i personave të lidhur me institucionin mikrofinanciar

30.1. Nëse AQBK-ja konstaton se ndonjë administrator, punonjës ose mbajtësi i interesit të rëndësishëm në një institucion mikrofinanciar me dashje apo në mënyrë të përsëritur ka bërë shkelje të kësaj Rregulloreje apo të ndonjë rregulle apo urdhri që ka rezultuar me humbje materiale për institucionin mikrofinanciar apo me përfitim financiar për personin e tillë apo është angazhuar në punë të pasigurta apo të pabazuara, dhe ka vazhduar me shkelje ose me punë të tilla pas vërejtjes me shkrim nga AQBK-ja, AQBK-ja mund të nxjerrë urdhër ku përfshihet ndonjëra apo të gjitha nga dispozitat:

- i) Kërkesa për shkarkimin e personit nga pozita e tij në institucionin mikrofinanciar;
- ii) Ndalimi i personit të tillë që të shërbejë apo të angazhohet në biznes bankar apo financiar për një periudhë të caktuar apo për tërë jetën;
- iii) Ndalimi i personit të tillë nga ushtrimi i drejtpërdrejtë apo i tërthortë i të drejtës për votim lidhur me aksionet në institucionin mikrofinanciar;
- iv) Kërkesa nga personi që të heq dorë nga tërë interesi pronësor i tij i drejtpërdrejtë ose i tërthortë apo nga një pjesë e atij interesi në institucionin mikrofinanciar apo të pushojë së mbajturi interes të rëndësishëm në të dhe
- v) Kërkesa që personi të kompensojë institucionin mikrofinanciar për humbjet e shkaktuara nga shkeljet e tilla.

30.2. Nëse personi i tillë ngarkohet me ndonjë vepër penale, AQBK-ja mund të lëshojë urdhër që përkohësisht të suspendojë personin e tillë nga pozita e tij në institucionin mikrofinanciar dhe, nëse është e mundshme, të suspendojë ushtrimin e të drejtës së votimit të aksioneve në institucionin mikrofinanciar nga personi i tillë, duke pritur vendimin për rastin penal. Refuzimi i rastit penal ose vendimi për pafajësi sipas meritave nuk do ta ndalojë AQBK-në nga veprim detyrim i lidhur me personin e autorizuar me këtë Rregullore.

30.3. Nëse personi nuk shet apo nuk largon aksionet e votuara të institucionit mikrofinanciar në pajtim me urdhrin e lëshuar sipas këtij neni brenda periudhës së përshkruar kohore, AQBK-ja mund të urdhërojë që të gjitha aksionet në institucionin mikrofinanciar të mbajtura nga personi i tillë të transferohen tek administruesi për shitje në ankand dhe fitimet neto, minus shpenzimet e shitjes, do t'i kthehen atij personi.

IX. LUKUIDIMI VULLNETAR DHE LIKUIDIMI

Neni 31 Likuidimi vullnetar

Nëse aksionarët, drejtorët ose pronarët e institucionit mikrofinanciar dëshirojnë që vullnetarisht të likuidojnë institucionin mikrofinanciar në pajtim me ligjin në fuqi, ata i paraqesin kërkesë për miratim të likuidimit vullnetar AQBK-së, të shoqëruar me informacione të tilla të përshkruara nga AQBK-ja. AQBK-ja do të bëjë hetimin e duhur të punëve të institucionit mikrofinanciar dhe, nëse sigurohet se interesat e depozitorëve ose interesat e kreditorëve të tjerë mund të mbrohen në mënyrë të kënaqshme, mund të miratojë likuidimin vullnetar sipas ligjit në fuqi.

Neni 32 Likuidimi

32.1. Nëse AQBK-ja konstaton se institucioni i licencuar mikrofinanciar është insolvent ose me arsye mund të pritët që të bëhet insolvent brenda nëntëdhjetë ditëve të ardhshme, AQBK-ja e revokon licencën e atij institucioni mikrofinanciar dhe menjëherë merr në posedim dhe nën kontroll atë institucion mikrofinanciar përmes likuidatorit të caktuar nga AQBK-ja. Kjo procedurë do të njihet si likuidim.

32.2. Pavarësisht nga çdo ligj në fuqi në Kosovë mbi bankrotimin, dispozitat lidhur me likuidimin që zbatohen për bankat, ashtu siç thuhet në nenet 39 deri në 45 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/21, zbatohen përshtatshëmrisht për institucionet e licencuara mikrofinanciare dhe do të kontrollojnë procesin e administrimit dhe likuidimit të institucioneve mikrofinanciare insolvente.

X. DISPOZITAT E NDRYSHME

Neni 33 Parandalimi i larjes së parave

33.1 Asnjë institucion mikrofinanciar nuk do të fshehë, konvertojë apo të transferojë para të gatshme apo pasuri tjetër, nëse ka ditur apo është dashur ta dijë se paratë e tilla të gatshme ose pasuria tjetër buron nga aktiviteti kriminal, ose të ndihmojë apo nxisë ndonjë person në fshehjen apo maskimin e prejardhjes së paligjshme të parave të gatshme apo pasurisë.

33.2 Institucionet mikrofinanciare e informojnë AQBK-në për çfarëdo faktesh të cilat sugjerojnë se pasuria mund të burojë nga aktiviteti kriminal dhe autoriteteve adekuate t'u sigurojë informacione shtesë, në pajtim me ligjin në fuqi dhe me rregullat e AQBK-së.

Neni 34
Kompetencat rregulative dhe mbikëqyrëse të AQBK-së

AQBK-ja do të jetë e autorizuar të nxjerrë rregulla, urdhra ose udhëzime të tilla për të vizituar zyrat e tilla të institucioneve mikrofinanciare në kohën e arsyeshme që e konsideron të duhur, për të kontrolluar llogaritë e tilla, librat, dokumentet dhe shënimet tjera, dhe të ndërmerr veprime të tjera të tilla që i konsideron të nevojshme ose të këshillueshme për realizimin e qëllimit të kësaj Rregulloreje, rregulle ose urdhri të nxjerrë për këtë.

Neni 35
Rregullat dhe urdhrat e AQBK-së; Tarifat

35.1. AQBK-ja do t'i publikojë rregullat dhe urdhrat e veta të cilat bëhen të plotfuqishme në datën e publikimit apo në një datë të mëvonshme të përcaktuar me një urdhër apo rregull të tillë.

35.2. AQBK-ja i ngarkon institucionet mikrofinanciare me tarifa për shërbimet e veta të mbikëqyrjes dhe të rregullimit për të mbuluar shpenzimet e veta të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që janë bërë gjatë ofrimit të këtyre shërbimeve. Tarifat ndaj institucioneve mikrofinanciare vlerësohen në relacion me shumën e aseteve të tyre apo në bazë të shpenzimeve të jashtëzakonshme të bëra nga AQBK-ja apo nga agjentët e saj lidhur me aktivitetet e veta mbikëqyrëse përkitazi me një institucion të caktuar mikrofinanciar. Institucionet mikrofinanciare do të paguajnë tarifa brenda dhjetë ditëve nga paraqitja e raportit nga AQBK-ja.

Neni 36
Kontrolli gjyqësor

Në çdo procedurë të cilësdo gjykate, në një tribunal të arbitrazhit apo organ administrativ për cilindo veprim apo masë të nxjerrë apo të ndërmarrë ndaj AQBK-së për ndonjë veprim të ndërmarrë nga AQBK-ja në cilësinë e mbikëqyrësit apo administratorit të përkohshëm, apo ndaj cilitdo nga zyrtarët e tij, punonjësve apo agjentëve:

- i) Pyetja e vetme pranë gjykatës ose organit në përcaktimin nëse i pandehuri ka vepruar në mënyrë të paligjshme, të gabueshme ose neglizhuese do të jetë nëse i pandehuri qartazi ka tejkalluar autorizimin apo ka vepruar në mënyrë arbitrare apo tekanoje duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat, dispozitat dhe qëllimin e kësaj Rregulloreje, rregullat, urdhrat dhe ligjin në fuqi;

- ii) Asnjë zyrtar, punonjës apo agjent i AQBK-së, qoftë aktual apo i mëparshëm nuk do të jetë përgjegjës për dëmet ose veprimet apo mosveprimet e kryera në mirëbesim gjatë kryerjes së detyrave të tij dhe
- iii) Veprimi i ndërmarrë që është çështje e cilësdo nga procedurat e tilla do të vazhdojë pa ndonjë kufizim gjatë procedurës si dhe çfarëdo ankese apo kontrolli gjyqësor përveç nëse ndalohet nga një gjykatë kompetente.

Neni 37
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të shpallë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 38
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk është në pajtim me të.

Neni 39
Rregulla e përkohshme

39.1 Të gjitha institucionet ekzistuese mikrofinanciare duhet t'i plotësojnë kushtet e kësaj Rregulloreje, së bashku me rregullat e zbatueshme të AQBK-së në të gjitha veprimet e tyre, dhe duhet të aplikojnë për regjistrim të ri jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje të ndryshuar.

39.2 Çdo institucion ekzistues mikrofinanciar që pranon depozita në bazë të dispozitës ... duhet të aplikojë për licencë të re jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, nëse dëshiron të vazhdojë të pranojë depozita.

Neni 40
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 29 maj 2008

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm